

Përshëndetje znj. I.,

Në vijim të kërkesës tuaj për informim, me emailin e datës 17.04.2025, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, kërkon informacion në lidhje me të drejtat politike të nëpunësve civilë, ju bëjmë me dije si vijon:

Të drejtat politike të nëpunësve civilë, si dhe kufizimet për këto të drejta, përcaktohen qartësisht në nenin 37, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ku parashikohet se:

*"Neni 37*

*Të drejtat politike*

- 1. Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.*
- 2. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre.*
- 3. Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra."*

Për sa i përket pyetjes tuaj lidhur me pjesëmarrjen e nëpunësve civilë në manifestime politike, në pikat 5 dhe 6 të VKM-së nr. 122, datë 26.2.2025 "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025", parashikohet se:

*"5. Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, por pa shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.*

*6. Nëpunësit civil, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, sipas pikës 5, të këtij vendimi, në kuptim të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, i ndalohe:*

- a) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat;*
- b) të manifestojë me pankarta, parrulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;*
- c) të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike apo të kandidatëve."*

Lidhur me nëpunësin konkret, nga të dhënat e administruara rezulton se në kuadër të një ankese mbi veprimtarinë politike të znj. Ç., është zhvilluar dhe një hetim administrativ nga institucioni ku është e punësuar.

Neni 10, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, përcakton se si rregull, çdo institucion në fushën e veprimtari të këtij ligji, krijon njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore. Njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet shprehimisht në këtë ligj që një vendim/akt administrativ

i caktuar, që ka të bëjë me marrëdhëniet e shërbimit civil, është në kompetencën e një nëpunësi apo një trupe tjetër posaçërisht të krijuar sipas këtij ligji. Në zbatim të këtij neni si dhe nenit 71 e vijues, të Kodit të Procedurave Administrative, njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka zhvilluar një hetim të thelluar administrativ pas marrjes së kësaj ankese.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ ka rezultuar se znj. Ç. nuk është anëtare e asnjë organi drejtues të partisë për të cilën janë ngritur pretendime në ankesë. Gjithashtu referuar analizave të fakteve dhe informacioneve të mbledhura, nga hetimi i kryer ka rezultuar se znj. Ç. është thjesht pjesëmarrëse në veprimtari politike, jashtë orarit zyrtar të punës, në respektim të së drejtës politike të nëpunësit civil dhe në asnjë moment nuk rezulton të ketë zhvilluar propagandë politike apo të ketë manifestuar në publik pikëpamje politike.